



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJE
KESHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 102 Date 20/11/2019

PER MIRATIMIN E PAKETES FISKALE 2020 TE BASHKISË KOLONJE

Ne mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore", Ligjit Nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, Ligjit Nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat Vendore", Ligjin Nr.10304 date 15.07.2010 "Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise", Ligjin Nr.9975 date 27.07.2008 "Per taksat Kombetare", i ndryshuar, Ligjin Nr.9385 date 04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor", i ndryshuar, Ligjin Nr.9693 date 19.03.2007 "Per fondin kullisor", i ndryshuar, Ligjin Nr. 10296, date 08.07.2010 "Per Menaxhimin Financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, VKM nr.391 date 31.06.2006 "Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave", i ndryshuar, Ligjin Nr.10465 date 29.09.2011 "Per sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise"; Ligjin Nr. 152/2015 date 21.12.2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin", VKM Nr.285 date 27.06.2002 "Per tarifat e sherbimeve qe kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi ndaj shtetasve dhe personave, juridike e fizike, vendas e te huaj", VKM nr.784 date 09.11.2016 "Per menyren dhe kriteret e llogaritjes se shpenzimeve te nderhyrjes per shuarjen e zjarreve ne objektet e siguruara ne administrimin e perdorimit te te ardhurave per llogari te sherbimit vendor MZSH-se" VKM Nr.632 date 11.06.2009 "Per miratimin e tarifave te perdorimit te kullotave dhe livadheve per kullotje dhe kositje", VKM Nr.783 date 10.11.2011 "Per procedurat e ndarjes se te ardhurave te takses vjetore te mjeteve te perdorura me njesite e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Ligjit Nr.107/2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Keshilli i Bashkise me propozim te Kryetarit te Bashkise

VENDOSI

1. Te miratoje paketen fiskale 2020 te Bashkise Kolonje (materiali bashkangjitur 33 flete).
2. Ky vendim hyn ne fuqi pas miratimit nga prefektura.
3. Per zbatimin e tij ngarkohet administrata e bashkise.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJE

Nr. 462 Prot

Ersekë më 13/12/2019

URDHER

Nr. 462 Date 13.12.19

PËR ZBATIMIN E PAKETËS FISKALE 2020


Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", ligjin 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018" si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak nr 102 ,të datës 20.11.2019 ,konfirmuar me shkresën nr 1526/2 datë 02.12.2019 të Prefektit të Qarkut Korçë , mbi bazueshmerinë ligjore të akteve të Këshillit :

URDHEROJ

1. Të zbatohet VKB nr 102, "Për miratimin e paketës fiskale 2020 të Bashkisë Kolonjë.
2. Ngarkohen Drejtoria e Finances ,Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse , Drejtoria e te Ardhurave , sektori i Bujqësisë,Sektori Pyjor,Bordi i Kullimit , Drejtoria e Urbanistikës ,Drejtoria e Shërbimeve ,Kultura për zbatimin e këtij Urdhëri.
3. Ky urdher hyn ne fuqi në datën 1 janar 2020.

KRYETAR

Erion SAJ



PAKETA
FISKALE
PER VITIN
2020

BASTUKA KOLONGE

RELACION

PER MIRATIMIN E PAKETES FISKALE ME NIVELET E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE SI DHE MIRATIMIN E PROCEDURAVE PER MBLEDHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE NE NE ZBATIM TE LIGJIT NR 9632,DATE 30.10.2006 “ PER SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE “ I NDRYSHUAR SI DHE MBESHTETUR NE NENIN 54, SHKRONJA “ F” TE LIGJITNR 139/2015 ,DATE 17.12.2015 “ PER VETEQEVERISJEN VENDORE

Të nderuar Këshilltarë !

Ju paraqesim paketën fiskale me nivelet e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Kolonjë.

Paketa fiskale është dokumenti bazë mbi të cilin mbështetet njësia vendore për të kryer aktivitetin e saj lidhur me njohjen dhe vjeljen e të ardhurave.Një paketë fiskale e qartë,e strukturuar si duhet dhe reale është bazë për të planifikuar një buxhet sa më real dhe të mirë.

Cfare prezanton kjo paketë fiskale ?

- ❖ Paketa fiskale është një rishikim i paketave fiskale të vitit të kaluar , në tërësinë e të cilës janë bërë ndryshime të cilat janë evidentueshme.
- ❖ Është bërë ndryshim te taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- ❖ Janë bërë ndryshime te tarifat e bashkisë ,kryesisht tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve ,si dhe tarifa e ndricimit në të cilat është synuar permirësimi i cilësisë dhe cka është më e rëndësishme është zbatimi i ligjit i cili orjenton tarifën drejt kostos .Gjithashtu tek këto tarifa kemi diferencuar kategoritë lehtësuese të cilat në paketat e kaluar nuk jane përfshirë .
- ❖ Ka ndryshime të lehta të tarifës së hapësirave publike, duke përcaktuar dhe muajt për pjesën e tarifës për zënie të përkohëshme .
- ❖ Ndryshim tek tarifa e tregëtimit për personat e rretheve te tjera që tregëtojnë në hapësirat publike me rroba të përdorura .
- ❖ Ndryshime janë bërë për disa kategori tek tarifa e parkimit .
- ❖ Janë reduktuar tarifat e regjistrimit të biznesit të cilat kanë qënë të debatueshme nga të gjithë bizneset dhe e cila i frenon në hapjen e tij .
- ❖ Ka ndryshim në dhënien e lejeve dhe autorizimeve kopentencë e bashkisë .
- ❖ Është shtuar tarifa për përdorim ujëmbledhësi për aktivitet peshkimi .
- ❖ Është shtuar tarifa administrative për përcjellje të dokumentacionit në Zyrën vendore të ASHK.
- ❖ Është shtuar si tarifë e re tarifa për shërbime për qytetarët , nisur nga kërkesat që kemi pasur nga qytetarë të ndryshëm për përdorimin e mjeteve të bashkisë sonë kundrejt tarifave .
- ❖ Është shtuar si tarifë e re tarifa e zhvillimit të turizmit e cila është e përkohëshme vetëm për 3 vjet ,kjo si një iniciativë për ti dhënë një shtysë më shumë zhvillimit të turizmit në bashkinë tonë .
- ❖ E re është dhe tarifa për dhënien në përdorin të tubacioneve nëntoksore dhe ajrore për telefoni ,kabllore , internet etj)
- ❖ Ndryshime janë bërë dhe tek pjesa e nivelit të gjobave me ndryshime dhe nivele te reja gjobash të cilat nuk ishin të miratuara në paketën e vitit 2019.

Vizioni ynë është për një teritor bashkiak të integruar duke parashikuar planifikuar dhe investime që krijojnë mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm ,të balancuar në të gjithë teritorin duke mbrojtur burimet natyrore .Mirëadministrimi i burimeve financiare nëpërmjet planifikimit sa më real të paketës fiskale si dhe zbatimi me rigorozitet i rregulloreve dhe urdhërezave do të jëtë moto e punë sonë .

Planifikimin e kemi mbështetur në shpërndarjen sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas llojit të aktivitetit , sipas vendodhjes gjeografike , duke lehtësuar bizneset në zonat më pak të zhvilluara .

Në synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon në punën tonë të përditëshme për të aritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona afatgjata.

Kjo paketë fiskale përmban :

Hartimin e një pakete fiskale të integruar

Rishikimin e kornizes ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave , tarifave dhe cdo pagese tjeter që ndikon në buxhetet vendore dhe per te cilat njesia vendore duhet të arkëtoje të ardhura

Saktësimin e procedurave , afateve , aktorëve , veprimeve ,përgjegjesive per cdo taksë dhe tarifë , pjesë e kësaj pakete fiskale . Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent .

Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat .Cdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët :

Taksim i drejtë

Klasifikimi i biznesit dhe lloji i aktivitetit

Percaktimi i taksave dhe tarifave per kategorite e familjeve sipas vendndodhjes

Analiza e taksave që aplikohen për teritorin që mbulon njësia (mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi) përcaktimi dhe detajimi në kategori , unifikimi i kategorive për të gjitha taksat , përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji

Rikategorizimi dhe detajimi i taksave

Analiza e tarifave që aplikohen për teritorin që mbulon njësia ,percaktimi dhe detajimi në kategori ,unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat , përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilën vendosen

Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë sic parashikon ligji .

LIDHJA NR.1

TAKSA DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË KOLONJË PËR VTTIN 2020

Mbështetur në :

- 1.Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015.;Ligji nr,106/2017 “ Per disa shtesa dhe ndryshime “
- 2.Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ *Për vetqeverisjen vendor*”
- 3.Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, “*Për tatimin mbi të ardhurat*”, i ndryshuar.
- 4.Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “*Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit*”;
5. Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 6.Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, “*Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar”Udhezimi I ministrit të punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit nr.11.date.18.12.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne udhëzime nr.156 datë 24.07.2007,për kriteret dhe procedurat e leshimit te te licensave ,autorizim dhe çertefika per ushtrimin e veprimtaris në transportin rrugor.
- 7.Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar
- 8.Ligji nr. 93/2015 “*Për turizmin*”;
- 9Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, i ndryshuar;
- 10Ligji Nr 107/2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”;
- 11.Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*”;
- 12.Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 “ *Për tarifat në sektorin e Kullotave*”,
- 13.Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
- 14.Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.132,datë 07.03.2018 “ Për metodologjinë e vlerës së taksueshme të pasurisë së palujtshme “ Ndërtesa”

1. MIRATOI TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË KOLONJË PER VITIN 2020

Paketa Fiskale e Bashkisë Kolonjë përbëhet nga :

I. TAKSAT VENDORE

- 1.Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël
- 2.Taksa mbi pasurinë e paluajtshme
 - 2.1 Taksa mbi ndërtesat
 - 2.2 Taksa mbi tokën bujqësore
 - 2.3 Taksa mbi truallin
- 3.Taksa e fjetjes në hotel
- 4.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja
- 5.Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme
- 6.Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin,riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:
- 7.Taksa e tabelës
- 8.Takesa e Kontrollit Veterinar
9. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura
10. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale
- 11.Të ardhura nga renta minerare.

II . TARIFAT VENDORE

- 1.Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave
- 2.Tarifa e ndriçimit
- 3.Tarifa për zënien e hapësirave publike
- 4.Tarifë tregëtimi
- 5.Tarifë parkimi per automjetet
- 6.Tarifë regjistrim veprimtari Private
- 7.Tarifë për Liçensë /Çertifikatë në fushën eTransportit rrugor
- 8.Për Leja sherbimi, liçenca . autorizime(Kopetence e Bashkise)
- 9.Tarifa shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj
- 10.Tarifë e sektori të ujitjes dhe kullimit
- 11.Tarifat e fondit pyjor dhe kullosor.
- 12.Tarife të ardhura nga Administrata për shërbimet .
- 13.Tarife për gjueti dhe peshkim amator.
- 14.Tarifë shërbimi për qytetarët
- 15.Tarifë e përkohëshme për zhvillimin e turizmit
- 16.Tarifë për dhënjën në përdorim të tubacioneve nëntokësore dhe ajrore ,për shtrirjen e linjave nëntokësore dhe ajrore (telefon ,energji,tv,kabllor,internet etj .

III. GJOBA PËR MOSSHLYERJE NË AFAT TË DETYRIMIT.

- 1.Mosshlyerje të detyrimeve tatimore (taksa, tarifa)
2. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore
3. Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative
- 3/1 Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore
- 4.Niveli i gjobave për ndotje të hapësirës publike **dhe ndotje akustike**
- 5.Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licensë, autorizim apo leje përkatëse
- 6.Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e ndriçimit rrugor, **rrjetin e kanalizimeve dhe ujsjellësave**
- 7.Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta dhe publike **si dhe fasadat**
- 8.Niveli i gjobave për inspektoriatin veterinar
- 9.Niveli i gjobave **në sektorin e bujqësisë, pyjorës dhe bordin e kullimit**
- 10.Niveli i gjobës për përdorimin e pa autorizuar të logos së Bashkisë së Kolonjës
- 11.Niveli i gjobës për dëmtime të objekteve të rëndësisë së veçantë.

IV .TË ARDHURA JO TATIMORE

1. Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë
2. Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime
3. Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve
- 4.Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara

TE DHENA E PERDORIMIT TE TOKES NE TERRITORIN E BASHKISE KOLONJE

Territori i bashkise Kolonje shtrihet ne nje siperfaqe prej 83167 ha.

Zonat e perdorimit sipas funksioneve kryesore baze jane:

1. Zona urbane, siperfaqja 584 ha, 0.7% e siperfaqes te territorit te Bashkise.
2. Zona bujqesore, siperfaqja 10512 ha, 12.6% e siperfaqes se territorit te Bashkise.
3. Zona natyrore pyje kullota, siperfaqja 65926 ha, 79.3% e siperfaqes se territorit te Bashkise.
4. Te tjera, siperfaqja 6145 ha, 7.4% e siperfaqes se territorit te Bashkise.

Nenzonat e ndara sipas funksioneve baze:

1. Zona urbane.

1.1 Nenzona e parcelave ndertimore per banim, siperfaqja 406 ha, 69.5% e siperfaqes te territorit te zones.

1.2 Ndertesa banimi brenda zones urbane pa fshatrat e braktisura siperfaqja 440 535 m2.

1.3 Rruge brenda zones urbane (njesia administrative, Erseke, Qender Erseke, Leskovik) siperfaqja 32ha.

2. Zona bujqesore, siperfaqja 10512 ha, 12.6% e siperfaqes se territorit.

3. Zona natyrore pyje kullota, siperfaqja 65926 ha, 79.3% e siperfaqes se territorit.

3.1 Pyll i dendur 18910 ha, 28.7% e siperfaqes se zones pyje kullota.

3.2 Pyll i rralle siperfaqja 4767 ha, 7.2% e siperfaqes se zones pyje, kullota.

3.3 Shkurre e dendur siperfaqja 10035, 15.2 % e siperfaqes se zones pyje, kullota.

3.4 Shkurre e rralle siperfaqja 10190 ha, 15.5% e siperfaqes se zones pyje, kullota.

3.5 Kullote siperfaqja 20740 ha, 31.5% e siperfaqes se zones pyje, kullota.

4. Te tjera, sipërfaqja 6145 ha, 7.4% e sipërfaqes se territorit.

5. Transport auto sipërfaqja 186.3 ha.

5.1 Rruge nacionale sipërfaqja 84.3 ha.

5.2 Rruge rurale sipërfaqja 102 ha.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", *Njësi Administrative Kolonjë* quhet zona urbane që zinte Bashkia Ersekë përpara ndarjes së re territoriale.

Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës , të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

-Ndarja në Lagje dhe Fshatra në Njësite Administrative te Bashkisë Kolonjë

Nr	Njësi Administrative	Lagje / Fshatra
1	Ersekë	Blloku nr.1,Blloku nr.2,Blloku nr.3,Blloku nr.4,Blloku nr.5,Blloku nr.6
2	Leskovik	Blloku nr.1,Blloku nr.2,Blloku nr.3,Blloku nr.4
3	Qender Ersekë	Selenice,Kreshove,Starje,Rehove,Bejkove,Psarr,Gostivisht,Kodras,Kabash, Taç-Posht,Taç Qender,Taç-Larte,Gjonç,Prodan,Borove,Lëngëz
4	Qender Leskovik	Radat,Pobickë,Cerckë,Glin,Radovë,Lashovë,Vrëpckë,Radanj,Podë, Gërmenj, Gjirakarë,Peshtan,Kovaçish ,Postenan,
5	Mollas	Mollas,Shtike,Qinam,Qafzez,Butke,Helmes,Skorovot,Milec,Vodice,Boshan,j,Blush,Pepellash,Bezhan
6	Novosele	Novosele,Mesiçke,Kagjinas,Kaduç,Dërmar,Mbreshtan,Shijan,Zharkanj,Piskal ,Vitisht
7	Barmash	Barmash,Kamnik,Sanjollas,Leshnje,Gozhdarazhde,Shales,Bënjëz,Radimisht,Rajan
8	Çlirim	Çlirim,Qyteze,Selenice e Pishes,Psarr I Zi,Kaltanj,Kurtës,Qesarkë,Lenckë,Radovickë,Luaras ,Qinam Radovickë

I. TAKSAT VENDORE

I.1.Tatim i thjeshtuar mbi biznesit e vogël (Eshtë e ardhur që mblidhet nga pushteti qëndror dhe me aktrakordim behët kalimi ne pushtetin vendor për pjesen që i takon)

I.2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë,pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo

përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshem.

2.1 Taksa mbi ndërtesat

Nivelet Taksa mbi ndërtesat paraqitet si më poshtë:

Emertimi i kategorive dhe nënkategorive	Baza ligjore	Niveli i Takses mbi ndërtesat					
		Njesit, Erseke/Leskovic		Njesite Administrative Qëndër Ersekë, Mollas, Clirim, Barmash, Novosele		Njesite Administrative Qëndër Leskovic	
		Propozuar	Miratuar	Propozuar	Miratuar	Propozuar	Miratuar
Ndertese banimi	Sipas ligjit	<i>-30%te 0.05% sipas metodologjise se taksës së ndërtesës</i>	<i>-30%te 0.05% sipas metodologjise se taksës së ndërtesës</i>	<i>- 35 %të cmimit të referencës të njësisë administrative Erseke</i>	<i>- 35 %të cmimit të referencës të njësisë administrative Erseke</i>	<i>- 35 %të cmimit të referencës të njësisë administrative Leskovi</i>	<i>- 35 %të cmimit të referencës të njësisë administrative Leskovic</i>
Ndërtesa që nuk shërbejnë për banim	Sipas ligjit	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Ersekë dhe Leskovic	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Ersekë dhe Leskovic	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Ersekë 23.000 me zbritje - 35%	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Ersekë (23.000 lekë me zbritje - 35%)	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Ersekë dhe Leskovic (21.000 lekë me zbritje - 35%)	+30 % e 0.2% të cmimit të referencës për qytetin Leskovic (21.000 lekë me zbritje - 35%)

Cmimi i referencës për banesa sipas VKM 132 datë 07.03.2018 për qytetin Ersekë është 23.000lekë/m²

Cmimi i referencës për banesa sipas VKM 132 datë 07.03.2018 për qytetin Leskovik është 21.000lekë/m²

Tarifat sipas metodologjise

Kategori dhe nenkategori	Njesia	Niveli i Takse mbi ndërtesat			
		Sipas ligjit	Propozuar	Miratuar	shpjegimi
Banesa per qëllim banimi në Erseke	leke/m ²	11.5	8.05	8.05	(-30%)të 0.05%
Banesa per qëllim banimi në Leskovik	leke/m ²	10.5	7.35	7.35	(-30%)të 0.05%
Banesa per qëllim banimi në Njësine Qëndër Ersekë,Mollas,Clirim ,barmash,Navosële	leke/m ²	11.5	5.23	5.23	(-30%)të 0.05% si dhe (-35%) te 23.000 leke/m ²
Njësi tregëtimi dhe shërbimi në njësinë Ersekë	leke/m ²	69	89.7	89.7	(+30%) të 0.2% te 34.500 leke/m ²
Banesa per qëllim banimi në Njësine Qëndër Leskovik	Lekë/m ²	10.5	4.78	4.78	(-30%)të 0.05% si dhe (-35%) te 21.000 leke/m ²
Njësi tregëtimi dhe shërbimi qyteti Leskovik	Lekë/m ²	63	81.9	81.9	(+30%) të 0.2% te 31.500 leke/m ²
Njësi tregëtimi dhe shërbimi nëNjësine Qëndër Ersekë,Mollas,Clirim ,barmash,Navosële	Leke/m ²	69	81.9	58.30	(+30%) të 0.2% te 22.475 leke/m ²
Njësi tregëtimi dhe shërbimi qyteti Leskovik dhe Njësine Qëndër Leskovik	Lekë/m ²	63	81.9	53.23	(+30%) të 0.2% te 20.475 leke/m ²
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale qyteti Ersekë	Lekë/m ²	13.8	17.95	17.95	(+30%)e vlerës 6900/m ²
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale Njësine Qëndër Ersekë,Mollas,Clirim ,barmash,Navosële	Lekë/m ²	13.8	17.95	11.67	(+30%)e vlerës 4.485lekë/m ²
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale qyteti Leskovik	Lekë/m ²	12.6	16.38	16.38	(+30%)e vlerës 6300 lekë/m ²
Veprimtari bujqësore dhe blegtorale njësia administrative Leskovik	Lekë/m ²	12.6	16.38	10.65	(+30%)e vlerës 4095 lekë/m ²
Parkime të mbuluara dhe bodrumet në qyteti Ersekë	Lekë/m ²	32.2	41.86	41.86	(+30%)e vlerës 16.100lekë/m ²
Parkime të mbuluara dhe bodrumet në Njësine Qëndër Ersekë,Mollas,Clirim ,barmash,Navosële	Lekë/m ²	32.2	41.86	27.20	(+30%)e vlerës 10.465 lekë/m ²
Parkime të mbuluara dhe bodrumet në qyteti Leskovik	Lekë/m ²	29.4	38.22	38.22	(+30%)e vlerës 14.700 lekë/m ²

Parkime të mbuluara dhe bodrumet Njësine Qëndër Leskovik	Lekë/m2	29.4	38.22	24.84	(+30%)e vlerës 9.555lekë/m2
Parkim i hapur në qytetin Ersekë	Lekë/m2	13.8	17.95	17.95	(+30%)e vlerës 6.900lekë/m2
Parkim i hapur në njësitë administrative QëndërErseke,Mollas,Clirim,Navosele,Barmash	Leke/m2	13.8	17.95	11.67	(+30%)e vlerës 4.485 /m2
Parkim i hapur në qytetin Leskovik	Lekë/m2	12.6	16.38	16.38	(+30%)e vlerës 6.300/m2
Parkim i hapur në qytetin Leskovik dhe njësitë administrative Qëndër Leskovik	Lekë/m2	12.6	16.38	10.65	(+30%)e vlerës 4.095/m2
Veprimtari industrial qyteti Erseke	Lekë/m2	23	29.9	29.9	(+30%)e vlerës 11.500/m2
Veprimtari industrial në Njësinë Qëndër Ersekë,Mollas , Barmash , Navoselë	Lekë/m2	23	29.9	19.4	(+30%)e vlerës 7.475/m2
Veprimtari industrial qyteti Leskovik	Lekë/m2	21	27.3	27.3	(+30%)e vlerës 10.500/m2
Veprimtari industrial qyteti Leskovik dhe njësitë administrative Qëndër Leskovik,	Lekë/m2	21	27.3	17.75	(+30%)e vlerës 6.825/m2

Kategoritë përjashtuese nga taksa e ndërtesës janë sipas ligjit nr 106/2017 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr 9632 , datë 30.10.2006 “ Sistemin e taksave vendore “ të ndryshuar.

2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Kategorite mesatare të tokës Bujqësore	Njesia	Niveli i taksës mbi token Bujqësore për të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Kolonjë	
		<i>Sipas ligjit</i>	<i>Miratuar</i>
I	lekë/ha/vit	1.400	1.400
II	lekë/ha/vit	1.200	1.200
III	lekë/ha/vit	1.100	1.100
IV	lekë/ha/vit	1.000	1.000
V	lekë/ha/vit	900	900
VI	lekë/ha/vit	800	800
VII-X	lekë/ha/vit	700	700

2.3 Taksa mbi truallin

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Emertimi i kategorive dhe nënkategorive	Njesia	Niveli i takses mbi truallin për të gjitha njësité administrative të Bashkisë Kolonjë.	
Taksa mbi truallin		<i>Sipas ligjit</i>	<i>Miratuar</i>
1.Për qëllime banimi nga individët	lekë/m ² /vit	0.14	0.14
2.Për qëllime biznesi	lekë/m ² /vit	12	12

I.3.Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi: Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë”Standard, “Fjetinë”Standard, Komfort;“Kamping”Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel”Standard, Komfort, Superior;“Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Emertimi i kategorive dhe nënkategorive	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel për të gjitha njësité administrative të bashkisë Kolonjë	
Taksa e fjetjes në Hotel		<i>Sipas ligjit</i>	<i>Miratuar</i>
Hotel me 4-5 yje	lekë/natë qëndrimi/për person	105	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35	35

I.4. Të miratojë Taksën e Ndikimit ne Infrastruktura nga Ndertimet e Reja si dhe nivelin e saj sipas kategorive dhe nenkategorive te investimeve si me poshte:

I.4.A - TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror për qytetin dhe për njësitë administrative taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Për banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave për strehimin e familjeve të pastreha, pavarësisht nga zona ku ndërtohet, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të jetë 4 për qind çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror sipas preventivit ose çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit do të jetë 3 për qind e kësaj vlere. Në këtë rast përfshihen edhe investimet për ndërtime që shërbejnë për banim të realizuar nga vetë investitori dhe që destinohen për përdorim vetiak të investitorit dhe jo për qëllime shitjeje, pavarësisht se ky ndërtim realizohet me shoqëri ndërtimi apo nga vetë investitori.

4. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

5. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Për ndërtimet në proces legalizimi, objekt i dytë, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të llogaritet si ndërtimet e reja që trajtohen me leje ndërtimi (Pika 2 dhe 3).

6. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

7. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

8. Pagesa e taksave do të kryhet pas miratimit të vendimit dhe zbardhjes së tij por jo më vonë se 15 ditë.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kolonjë.

I.4.B - TARIFA TË DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

a) Shqyrtimi i kërkesave për Leje Ndërtimi, Infrastrukturore, Rikonstruksione etj. pranë Bashkisë Kolonjë :

Kërkesa për leje ndërtimi, Infrastrukturore për rikonstruksione dhe struktura banimi individuale **5,000 lekë**

Banesa të grupuara, kolektive, dhe të gjitha llojet e tjera jo banim **10,000 lekë**

Deklaratë Paraprake për kryerje punimesh **3,000 lekë**

Leje për ndryshim projekti gjatë ndërtimit **3,000 lekë**

Leje ndërtim për prishje të ndërtimit ekzistues **3,000 lekë**

Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit **3,000 lekë**

Leje për ndryshim funksioni **3,000 lekë**

Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues **3,000 lekë**

Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues **3,000 lekë**

Autorizime për punime që nuk kërkojnë Leje **2,000 lekë**

b) Kontrolli pas përfundimit të karabinasë **1,000 lekë për kat**

c) Tërheqje leje përdorimi :

Për banesat e grupuara dhe kolektive si dhe për të gjitha objektet e tjera përveç atyre me destinacion banim **50 lekë/m²**

Për banesa individuale **20 lekë/m²**

ç) Fotokopjimi i planshetave në shkallën 1/500, 1/2000 :

Format A4 **200 lekë**

Format A3 **300 lekë**

d) Tarifë për aplikim Leje Zhvillimi **5,000 lekë**

Strukturat e ngarkuara për vjeljen e këtyre tarifave janë Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Financës në Bashkinë Kolonjë.

I.5.Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit,pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë e tjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës:

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Niveli i Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është paraqitur si më poshtë:

Emertimi i kategorive dhe nënkategorive	Njësia	Të gjitha Njësit Administrative
		Sipas ligjit
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe Shërbime	Lekë/m ²	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200

Vjelja e kësaj takse bëhet nga Zyra e Pasurive të Paluajtshme në rolin e agjentit tatimor .

I.6.Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkues i lejes për ndërtimin,riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin,riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Kontrollit të zhvillimit të territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes,përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

I.7.Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë ose

aktivitetin e biznesit , në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve.

Niveli i Taksa e tabelës është paraqitur si më poshtë:

Nr	LLOJET E TABELAVE	Njesia	Niveli i taksës së Tabelës			
			Bashkia Kolonjë		Njesie e Tjera	
			Sipas ligjit	Miratuar	Sipas	Miratuar
I.	<i>Takse tabele per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve (ku shenohet emir dhe/ose aktiviteti i biznesit)</i>					
a.	Deri ne 2 m2	lekë/m ² /vit	0	0	0	0
b.	-mbi 2 m2 deri 10 m2					
	- E thjeshte(pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	7.000	7.000	7.000	7.000
	- Me ndriçim te thjeshte	lekë/m ² /vit	11.500	11.500	11.500	11.500
	- elektronike	lekë/m ² /vit	15.000	15.000	15.000	15.000
c.	Mbi 10 m2 deri 20 m2	lekë/m ² /vit				
